VENDIM
Nr.102, datë 6.2.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE TË MASËS SË MBULIMIT TË ÇMIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.119/2012, "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Mbulimi i çmimeve të barnave të listës së barnave që rimbursohen, sipas klasifikimit ATC, të jetë në masën 50 për qind deri në 100 për qind, sipas grupeve terapeutike dhe barnave të përcaktuara në pasqyrën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Mbulimi i çmimit të barnave për alternativën e parë në listën e barnave të rimbursueshme, për kategorinë e pensionistëve, të jetë në masën 100 për qind.
4. Miratimin e marzheve të diferencuara të tregtimit, përkatësisht, në masën 10 për qind për tregtimin me shumicë dhe 26 për qind për tregtimin me pakicë, për barnat e listës së barnave të rimbursueshme, si dhe marzhet e diferencuara të tregtimit me shumicë e pakicë të disa barnave të listës, sipas pasqyrës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2013, miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
6. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetesor të përcaktojë kufizimet në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit me barnat e kësaj liste.
7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi nr.471, datë 18.7.2012 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha